



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280-390-112

SYLLABUS

Lënda: Gjuhë Angleze II

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik Programi: Juridik i Përgjithshëm
Titulli i lëndës:	Gjuhë Angleze II
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i I-rë, semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	Ligjërata: 10:00-11:30, A02 Ushtrime: G-1. 09:00-09:45, A02 G-2. 09:45-10:30, A02 G-3. 10:45-11:30, A02 G-4. 11:30-12:15, A02 Asistent: Mr.sc. Arlind Jerliu
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Shpresë Qamili
Detajet kontaktuese:	shpresa.qamili@uni-gjilan.net
Përshkrimi i lëndës	Kursi kombinon metodat më të mira tradicionale me ato bashkëkohore me studentin në qendër, për të ndihmuar studentët të përdorin gjuhën angleze saktë dhe rrjedhshëm. Gjuhë Angleze II ofron një atmosferë akademike të nivelit universitar që zgjeron përvojat e leximit dhe shkrimit të studentëve. Kursi do të ndihmojë studentët të përmirësojnë shkathtësitë e tyre të leximit, të shkrimit dhe të komunikimit përmes strategjive të ndryshme efektive që gjenden në kuadër të mësimi të përbashkët, duke përfshirë bisedat- interaktivitetin në klasë, punën grupore bashkëpunuese, shkrimin për të mësuar, grupet e shkrim-leximit, pyetje-përgjigje etj. Kursi gjithashtu prezanton edhe gramatikën me anë të teknikave të reja brenda qasjes komunikative. Kursi Gjuhë Angleze II bazohet në tekstin: New Headway,

	niveli Pre-intermediate, student's book, fourth edition si dhe materiale të tjera të përzgjedhura nga profesori i lëndës.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore të kursit janë: - të sigurojë materiale për studentët për të mësuar shqiptimin e tingujve në gjuhën angleze, të mësojnë të lexojnë, të shkruajnë dhe të njohin bazat e gjuhës angleze, gramatikën dhe fjalorin; - të zhvillojë aftësitë e leximit për t'u mundësuar studentëve që të kuptojnë përmbajtjen e një teksti të përshtatur, që të kuptojnë informatat specifike të një teksti të përshtatur, të interpretojnë një tekst të përshtatur. - të zhvillojë shkathtësitë e shkrimit të studentëve për t'u mundësuar atyre të nxjerrin, të zgjedhin, të përmbledhin informacione në një ese. - të zhvillojë aftësitë e dëgjimit të studentëve për t'u mundësuar atyre të kuptojnë dhe aplikojnë informacione specifike nga të dhënat. - të zhvillojë aftësitë e të folurit të studentëve për t'u mundësuar atyre të përdorin një gjuhë të përgjithshme, sociale dhe profesionale. - të zhvillojë kapacitetin e përgjithshëm të studentëve në një nivel që u mundëson atyre të përdorin gjuhën angleze në mjedisin e tyre profesional dhe akademik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi: - Studentët do të bëhen lexues aktiv që vlerësojnë dykuptimësinë dhe kompleksitetin dhe cilët mund të artikulojnë interpretimet e tyre me vetëdije dhe kuriozitet për perspektiva të tjera. - Studentët do të jenë në gjendje të shkruajnë në mënyrë efektive për tema profesionale dhe sociale. Ata do të praktikojnë shkrimin si një proces hetimi të motivuar, duke përdorur idetë e autorëve të tjerë ndërsa eksplorojnë dhe zhvillojnë idetë e veta. Ata do të demonstrojnë një aftësi për të rishikuar përmbajtjen dhe për të korigjuar gabimet gramatikore dhe stilistike. Dhe ata do të zhvillojnë një vetëdije dhe besim në zërin e tyre si shkrimtar. - Ata do të zhvillojnë një aftësi për të lexuar tekste në lidhje me historinë dhe kulturën e anglezëve në mënyrë që të kuptojnë më mirë kontekstin e teksteve. - Studentët do të demonstrojnë aftësitë e nevojshme për

	të marrë pjesë në një bisedë duke dëgjuar me kujdes mendimet e të tjerëve; duke artikuluar qartë idetë dhe pyetjet e tyre; dhe duke shfaqur e ideve të tyre.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	1/15	30 orë
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/15	30 orë
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10 min.	7	5 orë
Kollokfiume,seminare	2		2 orë
Detyra të shtëpisë	1	1/15	15 orë
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	1/30	30 orë
Përgatitja përfundimtare për provim	1	1/20	20 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	1/8	8 orë
Projektet, seminare, prezantimet ,etj	1	1/10	10 orë
Totali 150/25 orë = 6 ECTS			150 orë pune
<i>Lënda i ka 6 ECTS/150 orë pune, llogaritet si në vijim: Orë mësimi me mësimdhënësin: ligjëratat 2orë / në javë x15 javë /një semestër=30orë; Konsultimi me mësimdhënësin : 2-5 orë Koha e studentit për mësim individual (e llogaritur): puna në projekt= 30 orë; detyrat e shtëpisë dhe mësimi individual = 15 orë; përgatitja për provime = 20 orë</i>			
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërime, ushtrime në klasë, punë në çifte, punë në grupe, detyra të shtëpisë, kuize dhe kollokuime.		
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt në ligjërata, ushtrime dhe aktiviteti në klasë: 10% Detyrat e shtëpisë: 20% Testi i parë: 35% Testi i dytë: 35% Totali: 100 pikë. Vlerat e pikëve: Provimi ka 100 pikë. 50-60 = 6; 61-70 = 7; 71-80 = 8; 81-90= 9; 91-100 = 10 Pikët nën 50 nuk mbërrijnë notën kaluese.		

Literatura	
Literatura bazë:	John and Liz Soars (2012). New Headway, pre-intermediate student's book, fourth edition.
Literatura shtesë:	John and Liz Soars (2012). New Headway, pre-intermediate workbook, fourth edition. John and Liz Soars (2012). New Headway, pre-intermediate teacher's book, fourth edition. Oxford. Albanian-English Dictionary. (2000) Pavli Qesku (2002). English-Albanian Dictionary.

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	<i>Njoftimi me syllabusin</i>
<i>Java e dytë:</i>	<i>(Unit 7) Living History; Present Perfect-for and since; ever and never</i>
<i>Java e tretë:</i>	<i>(Unit 7) Chatsworth House; Present Perfect or Past Simple; Word endings and word stress; Questions tags;</i>
<i>Java e katërt:</i>	<i>(Un it 8) Girls and boys; have to/don't have to; should/must; problems;</i>
<i>Java e pestë:</i>	<i>(Unit 8) Sons and daughters; Things to wear; At the doctor's</i>
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>(Unit 9) Time for a story; Past perfect and narrative sentences; Joining sentences; The boy who cried wolf;</i>
<i>Java e shtatë:</i>	<i>(Unit 9) The strange case of Dr. Jekyll and Mr Hyde; feelings; exclamations with so and such;</i>
<i>Java e tetë:</i>	<i>Kollokuiumi i parë</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>(Unit 10) Our interactive world; Passives; Compound nouns; words that go together;</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>(Unit 10) Five internet firsts; Modern life drives me crazy; On the phone;</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>(Unit 11) Life's what you make it; Present Perfect Continuous; Tense Review;</i>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>(Unit 11) Four generations of Gettys; birth, marriage and death; good news; bad news;</i>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>(Unit 12) Just wondering; if+will/might/would conditionals; at a crossroads</i>
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	<i>(Unit 12) The wonders of our universe; Prepositions; thank you and goodbye;</i>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<i>Kollokuiumi i dytë</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Plagjiarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr notë negative.
Studenti/ja është i/e obliguar të vijojë ligjeratat dhe ushtrimet me rregull.
Ndalohet përdorimi i telefonave gjatë ligjëratave.